

DOKUDAILY

NUMRI I DYTË

EDICIONI XXIV

E SHTUNË, 2 GUSHT 2025

WE ANNOUNCE
DOKUFEST OPEN

Rekomandime

Faqe 03

Mbi ceremoninë

Faqe 04

Mbi filmat

Faqe 07 - 08

FOTO: ELMEDINA ARAPI

DEDIKIM PËR DOKUFEST-IN

Duhet ta pranoj, rrallëherë ndjej emocione të forta kur i risjell në kujtesë copëzat e udhëtimeve të shumta që njeriu përjeton gjatë jetës. Por kjo... kjo është ndryshe. Ndoshta sepse më kujton vazhdimisht sa shumë rëndësi kanë njerëzit e duhur, mjedisi i duhur dhe idealet e duhura, në momentin e duhur. U bashkova me DokuFest-in kur isha adoleshent, në një kohë kur ndoshta dija më pak nga sa mendoja, dhe po mësoja më shumë nga sa e kuptoja atëherë.

Shumë shpejt u njoha me filmat që ndriçonin mbi sfondin e gurëve të lashtë dhe atë dritë të artë të Prizrenit, që qëndron gjatë edhe pasi perëndon dielli. Mbi të gjitha, u bëra pjesë e një familjeje me njerëz që do të mbeten përgjithmonë mentorët e mi. Njerëz që e krijuan këtë lëvizje me një dashuri të pamasë, dhe me të njëjtën dashuri e rebelim, vazhdojnë të mbajnë gjallë pulsën e artit, kulturës dhe rezistencës.

Tetë vite më vonë, me të njëjtën magji dhe me të njëjtën etje për të parë, eksploruar dhe përthithur, kthehem tek vetja e dikurshme, duke menduar për atë shfaqjen e parë nën yje, kur turma hesht dhe duket sikur edhe vetë qyteti përkulet për të dëgjuar. Ndjej gjurmët e këtij transformimi në bisedat e vona buzë lumit, në të qeshurat që jehonin rrugëve të vjetra, në mënyrën se si ata që nuk i njohim largohen prej këtu si miq të lidhur nga një kujtim i përbashkët.

Për mua, DokuFest krahas të gjithave është të përfshihesh nga një rrymë krijimtarie dhe njerëzie. Ka të bëjë me një qytet që ia hap zemrën botës, dhe për një botë që përgjigjet me histori që na kujtojnë kush jemi dhe çfarë mund të bëhemi.

Vit pas viti, e ndjej si rikthim në shtëpi, në një vend që është njëkohësisht i njohur dhe i ri. Një vend ku koha ngadalësohet, ajri gumëzhin nga mundësitë, dhe ku e kupton se edhe në qoshen më të vogël të botës, bukuria mund të jehon pafund nëse ushqehet me dashuri.


Për DokuFest-in! Për atë javë kur Prizreni shndërron në poezi, dhe ne të gjithë, qoftë edhe për një çast të vetëm, kemi fatin të jetojmë brenda saj.

Shkruar nga Flutura Balaj.



REKOMANDIME

ELLIS PARK / 105'
SLANTED & ENCHANTED: MUSIC ON FILM



KINO ABI ÇARSHIA 1 17:00

THE VANISHING POINT / 104' -
HUMAN RIGHTS DOX



SHTËPIA E KULTURËS (SALLA E MADHE) 18:30

KNEECAP / 105'
FICTION/NON-FICTION



DOKUKINO PLATO 20:30

1984 / 110'
BLAST FROM THE PAST



DOKUKINO 22:00

RESISTANCE - WOMEN OF PEACE AND JUSTICE
IN FORMER YUGOSLAVIA AND ALBANIA
DOKUTALKS



SHKOLLA E MUZIKËS 'LORENC ANTONI' 17:00

BYRON YEATES X IN2STELLAR
X REBISWAN
DOKUNIGHTS



SONAR STAGE 23:59

MBI FILMAT

DokuFest hap edicionin e 24-të me refuzimin për të qenë dëshmitar neutral



FOTO: FERDI LIMANI

Vendi i zakonshëm i hapjes së festivalit ndërkombëtar të filmit dokumentar dhe të shkurtër në Prizren këtë vit ka ndryshuar. Për shkak të punimeve për rinovimin e Kinemasë Lumbardhi, ceremonia e hapjes së edicionit të 24-të të DokuFest është bartur në Kino Lumi, një vend tashmë emblematic i festivalit.

Ndonëse vendi i ceremonisë së hapjes ka ndryshuar, qasja e DokuFest për të prekur të ftuarit me imazhe e zë ka mbetur e njëjtë. Pa e thënë asnjë fjalë, të premtën mbrëma është përçarur sërish një deklaratë e fortë. Filmi i regjisorit Leart Rama ka sjellë reflektimin personal të autorit mbi temën e këtij viti të festivalit “Endless Greed Mental Void”, duke nxitur të pranishmit për reflektim mbi ndodhitë në botën e sotme.

“Të ndjesh do të thotë të vëresh. Të lejosh veten të preket nga ajo që po sheh, nga lajmet që merr, dhe nga ajo që po të thuhet. Të ndikohesh nga dridhja në një këndim, të vëresh rëndesën, dhimbjen në trupin e dikujt tjetër. Të ndjekësh të vërtetën, të mos heqësh dorë nga kërkimi i saj. Të njohësh humbjen, padrejtësinë, rezistencën, të drejtën, të gabuarën, vrullin e papritur të gjakut në gjithë trupin tënd. Të lejosh gjithçka të hyjë brenda, dhe të lejosh që gjithçka të dhembë. Të lejosh që ajo të të lëvizë. Të lejosh veten të shohë, të lejosh veten të qajë. T’u japësh vend ndjenjave të tua, t’i emërtosh ato, t’u besosh atyre, t’i lejosh të të ndryshojnë. Të qëndrosh me botën, edhe kur është më e lehtë të largohesh. Prandaj, faleminderit që erdhe, që u hape, që qëndrove këtu edhe pse dhemb. Që ndjeve dhe hyre në rrëfimet, edhe kur ato janë të rënda dhe të papërfunduara, si kjo që po shpaloset këtu, tani”, thuhet në shpjegimin e dhënë për filmin, i cili mund të shikohet [këtu](#).

Aty janë përfshirë fragmente nga filmi i papublikuar nga Leart Rama, pamje lajmesh të marra online, “Little Palestine: Diary of a Siege” nga Abdallah Al-Khatib, “I Have Never Been on an Airplane” nga Redon Kika, biblioteka e videove e NASA-s, “Ben’s Birthday” nga Robert Decani dhe “Israel Palestine on Swedish TV” nga Göran Hugo Olsson, derisa muzika është e Colin Stetson: The Lighthouse IV, Lord I Just Can’t Keep From Crying Sometimes, Lighthouse I dhe In Love and in Justice. Të gjitha këto kanë shpalosur paralele mes dhimbjes, vuajtjes, padrejtësisë dhe mos kokëçarjes e vazhdimi të rutinës jetësore, pa ndjenjën për anën tjetër të botës. Ndërsa kënga me vargjet “Kur do të mbarojë kjo dhimbje” ka mjaftuar për të përmbyllur këtë përjetim emocional, për ti dhënë vend në ekran porosisë: “E shpallim DokuFestin të hapur”

Si festival filmi nga Kosova, i një shoqërie dhe konteksti të pasluftës, DokuFest e ka bërë të qartë tashmë prej javësh se nuk bën të jemi dëshmitarë neutralë ndaj asaj që po ndodhë në botë, dhe me lehtësi të padurueshme të thithim padrejtësinë. Dhe këtë synon ta manifestojë edhe me programin e filmave, ngjarjet dhe diskutimet e shumta.

Dokumentari “The Helsinki Effect” (2025) i regjisorit Arthur Franck ka hapur programin e filmave në këtë edicion, duke risjellur në vëmendje një mbledhje diplomatike historike respektivisht Konferencën mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (CSCE) të vitit 1975 në Helsinki. Pavarësisht vlerësimeve se bëhej fjalë për një ngjarje të lodhshme dhe bajate, megjithatë filmbërësi ka krijuar një rrëfim të gjallë dhe me humor, teksa zbërthen rolin e saj vendimtar në transformimin e rendit botëror gjatë Luftës së Ftohtë.

Filmi përbëhet ekskluzivisht nga materiale arkivash, shkresa zyrtare dhe prezantime vizuale, ndërkohë që zërat e dy prej protagonistëve kryesorë të kësaj konference, Leonid Brezhnev dhe Henry Kissinger, janë simuluar me Inteligjencën Artificiale. Franck përmes veprës së tij 88 minutëshe shpalos se si Konferenca e Helsinkit pati ndikim të thellë në sigurinë e Evropës dhe se si ajo rezonon sot në botën e trazuar pas një gjysmëshekulli. Gjithashtu shpjegon ndikimin e marrëveshjes mbi krijimin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe nisma të tjera të rëndësishme. Për më tepër tregon se si diplomacia e ngadalshme pavarësisht paragjytimeve mund të sjellë rezultate të orientuara drejt ruajtjes së paqes.

Projeksionet e filmave në natën e hapjes kanë vijuar edhe në dy kinematë tjera. Filmat “The Encampments” dhe “Separated” janë shfaqur në “Kino Oborri”, derisa në platonë e DokuKinos janë shfaqur “Facing War” dhe “Coexistence, My Ass!”. Ekipi i DokuFestit gjatë shpalosjes së temës për këtë edicion ka bërë të ditur se: “Programi i këtij viti është përpjekje për t’u përgjigjë, për t’i rezistuar mpirjes, për ta shpëtuar gjuhën nga manipulimi. Për të këmbëngulur se akti i të treguarit, të dëgjuarit dhe të qenit bashkë vazhdon të ketë shumë rëndësi. Sivjet, filmat, bisedat dhe muzikën i prezantojmë si protestë, si thirrje. Kundër boshllëkut. Kundër dëshirës për t’u shkëputur nga realiteti. Kundër përsëritjes së vazhdueshme të aktit të harresës”.

Për të gjitha qëndrimet që mbajmë

NË BISEDË ME NITA DEDËN




FOTO: LUKA STRIKA

Pas ceremonisë së hapjes së DokuFest, takimi me Nita Dedën, që tanimë është pjesë e ekipit të kurimit muzikor të DokuNights, vjen si një bashkëbisedim për ta parë zhvillimin e shijeve muzikore, si e formësojnë apo lënë shenjë në një vend që e ka krijuar hapësirën e vetë të lirisë në një përmasë që mbledh atë që mund të nënvizohet si shpresë për të ardhmen e përzier me nostalgjinë e hapave të parë.

“Unë kam pas fatin, që kur jam bashkuar në Dokufest në vitin 2010, DokuNights ka qenë organizim i vogël, në disa ndeje në hapësira më të mbyllura si restorante e kur ka nisur të zhvillohet, ato krahë që t’i jep ekipi i Doku Festit, që është me mësu duke provuar, ato krahë m’i kanë dhënë edhe mua e veçanërisht Veton Nurkollari. Në vitet e para në krijimin e DokuNights, unë kam mësuar shumë, se çka do me thënë të punosh me audiencë dhe me qytetin e çka mund të shtyhet para si muzikë që të pëlqen.”

Ndër vite DokuNights ka mbledhur ndjekësit e vetë dhe këtë punë Deda ja atribuon eksperimentimit dhe të dëgjuarit e asaj muzike që e dëgjon gjatë gjithë vitit, por tanimë në vendin të cilin e jeton me ritmin dhe rutinën e kahershme. Bashkëpunimet e saj ka qenë të shumta ndër vite dhe ajo cek se bashkëpunimi për katër vite me Patrik Ukiq dhe vendosja e DokuNights në skenën e Andrrës, ka patur pritshmëritë e veta. Siç edhe ajo e thekson, që ka qenë proces i mësimit prej gabimeve dhe eksperimentimeve, për t’iu afruar sa më shumë audiencave. “Edhe kurimi i DokuNights ka patur në vete të sjellurit e një “statement”, ashtu sikurse programi i filmave i kuruar nga Vetoni dhe Samiri gjithmonë e sjellin. Kjo jo vetëm për t’i dhënë vend artistëve të jashtëm, por edhe për të aktivizuar skenën e vendit e kolektivet e reja funksionale.” E Nita sjell ndërmend performancat e Bijat apo Angry Youth ose Servisi apo aranzhime të ndryshme të punuara enkas për filmat.

Lidhur me të mbajturit qëndrim teksa përbri Kino Lumit qëndron instalacioni RESISTANCEEXISTENCE, për të i flet asaj çfarë DokuFest gjithmonë ka bërë, ashtu sikurse e cek videon hapëse të punuar nga Leart Rama, që i flet botës sikur t’ia ketë vënë pranë syve diagnozën e qartë dhe lehtësisht të lexueshme të terrorit kundër apatisë së thellë kolektive. Ajo e quan edhe pjesëmarrjen e bendeve si 47SOUL nga viti i kaluar, nga Palestina, apo DAKHABRAKHA, këtë vit nga Ukraina si një qëndrim jo vetëm për muzikën e shkëlqyer që këto bende lëvrojnë, por edhe si qëndrim njerëzor, jo për t’u parë si të ishim të impostuar në atë bosht moral që secili do të duhet të ishte, por të qenurit në solidaritet, empatik për ata që vuajnë fate të cilat nuk i meritojnë. E ky kujdes përkthehet edhe në kurimin e muzikës.

“Vitin e kaluar kemi eksperimentuar edhe me skenën, duke përdorur hapësira të ndryshme, për t’ia përshtatur artistëve e për ta shtyrë në një limit tjetër më të përsosur performancat e tyre e sivjet për shkak se Kino Lumbardhi është në renovim, na paraqitet një tjetër sfidë dhe ushtrim, për ta përdorur të njëjtën skenë, për secilin artist, në forma të ndryshme” - kështu thotë Nita kur i referohet punës së bërë në modelimin e këtyre performancave. Teksa shpreh entuziazmin për shumë performanca që do të nisin prej natës së sotme, ajo flet për Cinna Peyghamy, artiste të cilën e ka dëgjuar prej kohës, ftuar prej kohësh, e më në fund ajo vjen në DokuFest, me 6 gusht, e po ashtu flet për Ibadet Ramadanin, duke shënuar se kjo është hera e dytë që ajo vjen në DokuFest me një album të ri.

Qershia mbi tortë, mbetet nata e fundit, e Nita shprehet se këtë natë prej kohësh i rezervohet një performance nga Shqipëria, qoftë si vite më parë me Saz’ison apo River Voices të Osumit, apo Orkestra Shkodra vitin e kaluar këtë vit vjen Puls i Beratit.

Ky bashkëpunim me Edit Pulën për të disatin vit shërben jo thjesht për të mbledhur njerëz nën gëlimin e butë të muzikës shpirtërore shqiptare, por edhe si një moment vlerësimi dhe regjistrimi në kohë i kësaj gurre të pashtershme popullore e poetike, në një skenë, audiencë e së cilës është gjithmonë e hapur. Si vitin e kaluar Nita thotë: “Për performancën e Orkestrës Shkodra, ka patur njerëz plot që kanë zhvendosur krejt agjendat e tyre për të qenë në Prizren atë ditë pikërisht për ta patur këtë moment shkëmbimi të pastër e të çiltër”. Në rradhën e qëndrimeve, edhe kjo ftesë e një qyteti të Shqipërisë për të përmbyllur një festival në Prizren, qëndron e tillë, e mëvetshme.

Jemi në zanafillë të festivalit dhe Doku-Daily ka pyetur edhe zëra të tjerë të rëndësishëm në DokuFest lidhur me aspekte të ndryshme të kurimit në një kohë ku vëmendja jonë është e stërm-bushur me evente kulturore dhe me ngjarje të cilat duket se zgjerojnë edhe ditën. Në një moment të hipersaturimit me ngjarje të kulturës që bien në përsëritje, DokuFest e gjen një moment të frymëmarrjes dhe të përcjelljes së një shijeje që është e mbruar me vite të tëra. Nita shprehet se kjo përzgjedhje, ky proces, e ky standard duhet ta përbëjë natyrën e një programi: që duhet të jetë i çiltër, e jo arrogant.”

Në këtë bisedë për muzikën e patëm dhe një moment të të përkapurit të atij shpirti që mban DokuFesti që fton këdo të mësojë, të mos paragjykojë, të qëndrojë për gjërat e drejta, e kështu për të patur një shprehje që ashtu siç Nita e theksoi edhe në bisedë, që *Dokufest meriton ta ketë*.

MBI GARAT

Një busullë e vogël drejt kategorive në garim



FOTO: LUKA STRIKA

Duket se Prizreni e ka një aftësi elastike që të tirret veç për ta krijuar një xhep më shumë për kinemanë. Natyrisht, ky elasticitet kërkon dhe ka ekipe të tëra nga mbrapa e puna e tyre është e vërejtshme. Prej Kino Oborrit të Shtëpia e Kulturës, e prej DokuKinos e deri në Kino Abi Carshia do të ndjekim kategoritë në garim në këtë vit në DokuFest.

Kategoria e Balkan Dox sjell regjisorë nga vende të ndryshme të Ballkanit nga Turqia, Greqia, Maqedonia e Veriut etj, me fokuse specifike në materialitetin e të përjetuarit jetën në Ballkan, por jo vetëm mes pamundësive, keqkuptimeve dhe përballjeve të forta me historinë. Sot prej orës 20:30 në DokuKino Plato ju ftojmë të ndiqni arradhën e parë të filmave në këtë kategori me 12 prodhime.

Në International Feature Dox, bëhen bashkë rrëfime nga Kuba deri në Kroaci e nga Shtetet e Bashkuara deri në Ukrainë. Prej rrëfimeve intime, të izoluara, që e zbulojnë një botë të shumëfishtë në një cep të djerrë të botës, tek situatat absurde që mbijetesa të vë para përgjegjësisë, tek përballje emocionale ndër breza, kjo kategori me siguri ka synimin t'ia bëjë të vështirë jurisë përzgjedhjen. Kjo kategori nis shfaqjet në DokuKino prej 2 gushtit, ndaj bëhuni gati t'i përjetoni këto udhëtime të pazakon-ta.

Nga Korea e Jugut deri në Irlandën e Veriut e më gjërë, e drejt e në kinematë e Prizrenit, vjen kategoria në garim International Short Dox, me eksperimentime vizuale të thekshme, mes mahitjes dhe ndjekjes së realitetit sikur me një almanak. Prej pikëpamjeve se si ngjarje katastrofike e kanë zhbërë jetën, tek jeta e jetuar apostafat si për të qenë e dokumentuar, ju presin prej 3 gushtit në mbrëmje në DokuKino.

Prej ditës së sotme në orën 16:00 në Sallën e Madhe të Shtëpisë së Kulturës ju pret kategoria e International Shorts me filma që i flasin historive kudo në botë që po t'ia zhbënim gjeografinë do t'i ndjejmë sikur tonat.

Kategoria e Human Rights Dox, vjen me 8 filma sivjet DokuFest, vijnë me përballje të forta të shokut kulturor, të të luftuarit me entitete të patrupëzuara, me rrugëtime sflitëse drejt një jete në të cilën mund të merret frymë lirisht, e ju fton në Sallën e Madhe të Shtëpisë së Kulturës, prej 2 gushtit, në orën 18:30.

Mjedisi është një nga cështjet që pulson në alarm, e në kategorinë Green Dox, që zënë fill prej sot në Kino Oborri në orën 8, do ta gjejmë veten para rrëfimeve të kolapsit të tokës e të ajrit, e ku mishi i butë i jetës varet në zgrip.

Më së fundi, në këtë miniguide tonën, për t'ia nisur entuziazmit të garave të festivalit, ju ftojmë të ndiqni me shumë zell, garën kombëtare, që vijnë prej regjisorëve shqiptarë e nga diaspora me rrëfime që lidhin kohëra, botë e gjenerata në hullitë e të jetuarit në jetë plot me limite, angështi, por me një shpresë të jashtëzakonshme.

Për më tepër ne ju ftojmë të merrni programet në dorë e t'i mbushni me shënime e mendime, e nëse diku, dikur, programi juaj vendos të ketë një jetë të vetën, mund të shihni gjithë çfarë ndodh [online](#).



FOTO: FERDI LIMANI

MBI PROGRAMET E VEÇANTA

Një botë e tërë në kinematë e Prizrenit




FOTO: LUKA STRIKA

Gjatë këtij edicioni të DokuFest do të keni mundësinë të ndiqni një seri të programeve speciale që janë të kuruara nga ekipi i festivalit, për një shumësi shijesh. Në secilin organizim fo ta gjeni një moment të reflektimit, për të parë pamje nga vendi e bota, që i flasin mënyrën se si e njohim gjithësinë.

Programi për fëmijë ju drejton në ITP secilën ditë të festivalit prej orës 10:00, me hyrje të lirë, për këdo që do ta nisë ditën mbarë. Me rrëfime që i flasin imtësive të jetës dhe mesazheve të mëdha, të qenurit të ndërgjegjshëm packa moshës së re, ky program i cili është i ndërthurur me programe për moshë të ndryshme të reja si dhe një bashkëpunim të vyer me festivalin Clermont Ferrant Issf.

Me shumë endje presim shfaqjet e programit Future is Here, ku të rinj të ndryshëm nga vendi kanë përgatitur punimet e tyre filmike në Prizren. Këtë vit, për të 13-n herë, do të njihemi me kahjen e rrëfimeve të gjeneratave të reja. Një moment emocionues që nuk duhet ta humbisni me 6 gusht prej orës 20:00 në Kino Lumi.

Ditën e djeshme, programi i shfaqjes së filmave ja nisi me programin e View from the World, e në Ceremoninë e Hapjes me “The Helsinki Effect”, e do të vijojë gjatë gjithë javës në kinema të ndryshme në Prizren. Për më shumë informohoni [këtu](#) për ta shëtitur të gjithë botën në katër cepat e ekranit.

Për të gjithë ata që duan adrenalinën e sportit në këto netë verore, DokuFest ka përgatitur një program të filmave pikërisht për këta entuziastë në një përzgjedhje prej katër filmash që sjellin furinë e malit, ankthin para penaltisë, ujin e elementë që njerëzimi ka ditur si t'i kthejë në sfidë dhe emocion. Bashkohuni në DokuKino Plato me datë 6 gusht prej orës 22:30 dhe në Kino Lumi me 7 gusht prej orës 20:00 për të mos e humbur këtë eksperiencë.

Bashkëpunimet janë të shumta në programet speciale, si në rastin e bashkëpunimit të DokuFest dhe Fondacionit Lumbardhi me programin “Blast from the Past” ku do të paraqiten filma më 2, 4 dhe 8 gusht në kinema të ndryshme në Prizren, e që ia nis me filmin “1984”, vijon me një homazh ndaj regjisorit David Lynch, të ndarë nga jeta këtë vit me filmin “Lost Highway” dhe me filmin “O Bi, O-Ba: The End of Civilization” me regji nga Piotr Szulkin. Po në lëmin e bashkëpunimeve për të gjithë entuziastët e zhanrit eksperimental dhe të artit bashkëkohor vjen programi i Kontakt Collection dhe Autostrada Biennale për të cilin mund të mësoni më shumë [këtu](#).

Sot gjithashtu nisim prej orës 15:00 në DokuKino me programin me fokus në filmat e Brett Story, të kuruar nga Pamela Cohn. Program që s'duhet ta humbisni nëse jeni në Prizren.

Në mesin e gjithë programeve do të gjeni eksperimentime dhe spekulime mbi zhanrin dokumentar në programin “Fiction/Non-fiction” apo në programin “Special Screenings”.

Në vijim të kësaj jave do t'ju njoftojmë më me detaje mbi programet speciale dhe gjithë botën që ato mbartin brenda. Për momentin merreni këtë doracak të vogël dhe ecni me kutin e Prizrenit.




FOTO: SUER CELINA

DOKUNIGHTS

Teksa sot do të nisë performanca e parë e DokuNights, jemi para një etosi, gjendjeje e refuzimi për të parë botën rreth nesh. Tema e këtij edicioni të këtij viti është pranim i pandehjes: të rrethuar nga genocidi, uria masive dhe nga pangopësia e njerëzve në pushtet apo strukturave të gjera të pushtetit që refuzojnë të njohin a shohin në sy këtë kolaps kaq pranë nesh.

Eshtë e lehtë të shkosh nga kahu i kundërt i pafundësisë, të mbyllësh sytë dhe të vendosësh duart mbi sy. Ashtu sikurse bashkëkuratori i DokuNights, Leart Rama e thotë: *“Të jetosh në vitin 2025 nuk do të thotë të jetosh, por të ekzistosh e me gjasa do të bëhet më e vështirë para se të bëhet më mirë.”*

DokuNights nuk është një antidot i menjëhershëm për të gjitha këto, por refuzon të shikojë larg. Një program i kuruar me një mentalitet sfidues të hierarkive ekzistuese dhe duke u ofruar zëra artistëve të krahut të majtë që meritojnë kohën e tyre në qendër të vëmendjes, programi i tij është ai i kolektivitetit, rezistencës dhe shpirtit të lirë.

Të kërcejmë deri në pafundësi

Dhe mishërimi i kësaj janë që do të drejtojnë gjithë natën: tre DJ që operojnë me të njëjtën energji çliruese dhe ekspresive. Ne mirëpresim Byron Yeates, i cili mbikëqyr etiketën emocionuese Radiant Records dhe është themelor për serinë famëkeqe të festave queer La Noche; IN2STELLAR, një dyshe dinamike me bazë në Melbourne që ofron ritme galvanike për t'ju lënë të qëndroni pezull; dhe Rebiswan, një talent i Kosovës që shpërthen në skaje me një braktisje anarkike.

Këta janë tre DJ me vitalitet të jashtëzakonshëm dhe talent të pabesueshëm, të gjithë refuzojnë të kufizohen në struktura dhe etiketa të vendosura. Shkurt, ata janë hapësatë perfekt për kohët në të cilat gjendemi.


Sonte, dhe nesër, dhe në çdo ngjarje të DokuNights më tej, rregullat do të thyhen. Hierarkitë do të vihen në pikëpyetje. Pista e vallëzimit do të çlirohet. Sonar Stage në Kalaja ofron hapësirën pikërisht për këtë: një lumturi rebele që zgjat deri natën vonë. Po, Endless Greed Mental Void. Por ka fuqi në pranimin e gjithçkaje, në refuzimin për t'u thyer, në lejimin e vetes të lëkundesh pavarësisht gjithçkaje. E secili prej nesh e mbart një fuqi speciale teksa avitet të kërcejë në pafundësinë e humnerës.



General Sponsor



Principal Partner



Principal Partner



Golden Sponsor

